



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Datë: 27.08.2025
Numër Protokolli: 5742/2025

A.nr.719/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës–Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi, kryetare, Eshref Shabani dhe Malsore Gashi Bajraktari, anëtarë, me Kaltrina Avdullahi Prenaj, në cilësinë e procesmbajtëses, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.719/2025, të datës 24.04.2025, të parashtruar nga ankuesja E.K kundër organit të punësimit: Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, në çështjen juridike “*transferim sipas rristurimit*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të datës 27.08.2025, mori këtë:

V E N D I M

Përfundon procedimi administrativ i filluar sipas me numër A.nr.719/2025, të datës 24.04.2025, të parashtruar nga ankuesja E.K.

A r s y e t i m

Nëpunësja Civile E.K, (*tani e tutje referuar: ankuesja*), me datë 20.04.2025, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit MMPHI-446/2025, të datës 18.03.2025, të Drejtorit të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik/MPB.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesën e ankueses tek Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (tutje MMPHI), ndërsa, kjo e fundit, më datë 15.05.2025, ka dërguar përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat e bashkangjitura.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas shqyrtimit të shkresave të lëndës të parashtruar nga palët në procedurë konstatoi se procedura e iniciuar sipas ankesës A.nr.719/2025, duhet të përfundohet në kuptim të nenit 104 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, sepse:

Nga administrimi i shkresave të lëndës rezulton se ankuesja sipas Akt emërimit të datës 04.04.2012, ka qenë e punësuar në pozitën “*Shefe e Sektorit për Buxhet*”, në Divizionin për Buxhet dhe Financa pranë Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës.

Tutje sipas Vendimit me Nr.073/2024, të datës 29.03.2024, të Kryeministrit të Republikës së Kosovës, është miratuar Rregullorja (ZKM) Nr.08/2024 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, ndërsa, në kuadër të përgjegjësiave ligjore, Drejtori i Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në Ministrinë e Punëve të Brendshme më Vendimin me Nr.2392/2024, të datës 29.11.2024, ka themeluar Komisionin e Ristrukturimit për Ministrinë e Mjedisit, Planifikimi Hapësinor dhe Infrastrukturës, i cili më datë 03.03.2025, ka miratuar Raportin e punës me Nr.191 dhe propozimet lidhur me ristrukturimin për këtë institucion, duke propozuar që ankuesja të transferohet nga pozita e punës “Shefe e Sektorit për Buxhet”, në pozitën “Zyrtare e Lartë- Analiste e Buxhetit”.

Ankuesja në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës për kundërshton Vendimin MMPHI-194/2025, të datës 18.03.2025, të Drejtorit të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik, për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave ligjore, shkeljeve procedurale dhe vlerësimit të gabuar, jo real dhe jo të plotë të gjendjes faktike. Shton së me vendimin e atakuar është dëmtuar në aspektin material, ngase do të merr vlerën e pagës sipas koeficientit 5.75. Kërkon që të aprovohet ankesa, të anulohet vendimin i kundërshtuar me ankesë dhe të detyrohet DMZP-ja për ri caktim në një pozitë tjetër brenda të njëjtës kategori “Drejtues i ulët”.

Duke qenë se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës kishte pranuar disa ankesa të nëpunësve civilë të pakënaqur më procesin e ristrukturimit në MMPHI, Këshilli më Vendimin me numër A.nr.786/2025, të datës 11.08.2025, ka aprovuar ankesën e datës 30.04.2025, të parashtruar nga ankuesi B.T, duke shfuqizuar Raportin Përfundimtar të Komisionit të Ristrukturimit në MMPHI të datës 03.03.2025 dhe të gjitha vendimet dhe procedurat që rrjedhin nga ky raport.

Referuar gjendjes së fakteve si më lartë dhe duke marrë parasysh se objekti i kontestit sipas ankesës A.nr.719/2025, të datës 24.04.2025, ka të bëjë më vendimin për transferim për shkak të ristrukturimit, vendim ky, i pasuar si veprim nga zbatimi i Raportit Përfundimtar të Komisionit të Ristrukturimit në MMPHI të datës 03.03.2025, e duke qenë se ky akt është shfuqizuar si i paligjshëm me Vendimin A.nr.786/2025, të datës 11.08.2025 të KPMSHCK-së, atëherë, mbi bazën e këtyre rrethanave, e në kuptim të dispozitave të nenit 104 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative më të cilat është përcaktuar se: “*Procedura administrative gjithashtu përfundon kur organi publik kompetent vlerëson se objekti për të cilin ishte nisur procedura ose qëllimi i saj është bërë i pamundur apo i kot*”. Kolegji vlerëson se objekti i ankesës A.nr.719/2025, është bërë i pamundur për shqyrtim dhe vendosje.

Kështu që, në mbështetje të nenit 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe nenin 104 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji vendosi që të përfundoj procedimin administrativ të filluar me ankesën A.nr.719/2025, të datës 24.04.2025.

Këshillë juridike: Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda: A.nr.719/2025

Kaltrina Avdullahi Prenaj

Procesmbajtëse

Ardita Haxhnikaj DEMI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankueses, E.K;
- Drejtorit të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në MPB;
- Njesisë për Burime Njerëzore në MMPHI; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së